

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Duhet vetëm 46 bashki", Mazniku: Kundërshtimet ishin të pritshme, nuk cenohet asnjë shërbim për qytetarët – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/duhen-vetem-46-bashki-mazniku-kundershtimet-ishin-te-pritshme-nuk-cenohet-asnje-sherbim-per-qytetaret/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 23:30:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	1 shtator 2026, 13:19:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	213425b75d079f90dd732bd93d753a4632043277a47202f5ebd5b2eefcc421ff
TEKSTI	d8de39d12da57f51728bfabe2e8cd0e4a3bd06f3ebcdef4344511af2da430ab4
PAMJA	6bbe23805707b76cb5e47fb710eebf9846ec40e0b99c4dbc917eff1517d00ff

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	97ac0a27ee19f5ba6d48aeaa9395a26e2b4852e361e199774b1b109a147e4264
E MËPARSHMJA	6773663fe84aa5b28c19193337e0fc4dd75adb0eabfa21f1de43f93d9521bf64
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/97ac0a27ee19f5ba6d48aeaa9395a26e2b4852e361e199774b1b109a147e4264>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



mazhoranca nuk terhiqet nga propozimi per hartën e re territoriale me 46 bashki.

Për Vizion Plus, hartuesi i reformës nga socialistët, Arbjan Mazniku pranoi se kundërshtimet ishin të pritshme, megjithatë shtoi se shkrirja e bashkive të vogla nuk heq shërbimet por e kundërta.

“Ka disa palë të cilët fitojnë dhe ka disa palë të cilët fitojnë më pak ose ndihen të rrezikuar. Ne jemi nisur me një reformë nga këshillimi që kemi për të siguruar që qytetarët të marrin shërbime më të mira, që investimet në terren t’i bëhen më të mëdha dhe më eficiente, që punët publike të administrohen më mirë”, thotë Mazniku.

Qytetarët e bashkive të vogla sipas tij, nuk do t’iu duhet të shkojnë në qytetet e mëdha për të marrë shërbimet nga institucionet vendore.

“Asnjë shërbim i cili sot i ofrohet në njësinë e tyre administrative apo në bashkinë e sotme nuk do t’ju ofrohet në qytetin që krijohet me ligjin e ri. Ligji i ri krijon bashki, krijon qytetet dhe njësitë administrative. Nuk i ndërron asgjë qytetarit me reformën e re në raport me afërsinë e marrjes së shërbimit”, thotë Mazniku.

Mazniku jep edhe raste specifike ku bashkimi me qytetet e mëdha ka sjellë përmirësim infrastrukture dhe jo vetëm.

“Në Zona si Dardha e Korçës apo Gjinari i Elbasanit, pasi janë bërë pjesë e bashkisë, atje është përmirësuar infrastruktura, është përmirësuar turizmi, është përmirësuar marketingu i këtyre zonave, si zonë turistike”, thotë

5 Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Mazniku.

Me nisjen e sesionit të ri parlamentar këtë muaj, kjo temë do të sjellë debate në punimet e kuvendit, megjithatë socialistët i kanë të qarta prioritetet.

“Do ketë debate e diskutime, në territor, në bashkitë respektive. E rëndësishme është që ne t'i shpjegojmë qytetarëve të të gjithëve zonave që kemi vënë përpara një propozim i cili sjell nga njëra anë fuqizimin e bashkive, fuqizimin e mendësisë që bashkitë ti shërbejnë në mënyrë më eficiente qytetarëve”, sqaron ai.

Në 31 korrik, Partia Socialiste depozitoi në parlament hartën e re territoriale e cila propozon 15 bashki më pak. Por ky propozim shkaktoi protesta në disa zona të vendit si Përrenjasi, Klosi, Cërriku dhe Poliçani.

#Mazniku

#Reformaterritoriale



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



VENDI

**“Smart City”,
Kumbro: Kamerat...**

**Xhuljana
Zhuleku** 34 minuta
më parë



VENDI

**Nis shkolla, Kumbro
prezanton risitë në...**

**Xhuljana
Zhuleku** 46 minuta
më parë



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollos,
680 nxënës më pak...**

**Xhuljana
Zhuleku** 2 orë më
parë



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑